



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 MARS 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. MARTA 2016. GODINE**

**MARS - MART
2016**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve të Organin Shqyrtues të Prokurimit

Dnevni red

1. Razmatranje preporuke Nezavisnog izbornog organa za imenovanje članova Organa za razmatranje javnih nabavki

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e paraparë në seancën e mbajtur më 10 mars 2016.

Pikë e vetme e rendit të ditës është:

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Organi Përzgjedhës i Pavarur, i themeluar me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 100 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092, në takimin e mbajtur më 14 mars 2016 i ka intervistuar kandidatët për anëtarë në Organin Shqyrtues të Prokurimit të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e kryesuesit dhe të një anëtari të këtij organi në bazë të rezultateve të intervistimit, si në vijim.

1. Berim Dina, kryesues, dhe
2. Vjollca Shala-Kurtishaj, anëtare

Organi i Pavarur Përzgjedhës ka konstatuar se asnjëri nga kandidatët e propozuar nga komuniteti serb nuk i ka plotësuar kushtet formale sipas Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092.

Në qoftë se përfaqësuesi i Qeverisë dëshiron ta marrë fjalën sa i përket votimit ose përzgjedhjes së kandidatëve. Nuk është paraqitur askush.

Nga kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk dëshiron askush. Nga LDK nuk dëshiron askush. “Vetëvendosje” nuk është. Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është. Nga Lista serbe nuk është paraqitur askush. Nga “Nisma” askush. Nga “6+” askush. Nga deputetët, z. Abdyl Ymeri e ka kërkuar fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po e përmbushim një obligim që e ka Kuvendi për kompletimin e Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit si institucion me përgjegjësi ndaj zbatimit të procedurave të ankesave sipas kërkesave të operatorëve ekonomikë për shqyrtimin e rasteve të prokurimit.

Unë konsideroj se ky institucion për nga natyra dhe roli i punës që e ka, e ka një përgjegjësi të madhe në vendosjen e drejtësisë dhe eliminimin e mundshëm të padrejtësive të atyre operatorëve ekonomikë që pretendojnë se u është bërë e padrejtë gjatë zhvillimeve të procedurave të tenderimit. Pa dyshim se tashmë në bazë të të gjitha analizave, raporteve vendore dhe ndërkombëtare, prokurimi publik cilësohet si fushë e përshtatshme për zhvillimin e dukurive

negative. Po ashtu, nga ajo që kam parë në media dhe raportet e ndryshme, edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik nuk ka qenë shumë imun nga dukuritë e tilla.

Prandaj, konsideroj se Bordi i ri i OSHP-së duhet të jetë i përfaqësuar nga njerëz me kredibilitet moral dhe profesional, me qëllim të eliminimit të dukurive negative, duke e zbatuar ligjin dhe rregulloret me përpikëri, e po ashtu duke punuar në krijimin e një imazhi të mirë të këtij institucioni, sepse e kemi një imazh jo të mirë në publik për këtë institucion.

Mendoj se me punë të ndershme, me përkushtim dhe angazhim maksimal të të gjithëve që punojnë në këtë institucion mund ta përmirësojmë këtë imazh. Janë disa elemente që bordi i ri duhet t'i ketë parasysh në punën e tij, në mënyrë që ta krijojë një perceptcion tjetër nga ai që ka publiku sot për këtë institucion: krijimi i një imazhi të mirë, mosndikimi nga jashtë, rritja e nivelit të transparencës në maksimum, llogaridhënia.

Unë pyes: A është e mundur kjo? Besoj se po! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. E vazhdojmë seancën me votimin e rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e kryesuesit dhe të një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë janë të pranishëm 75 deputetë. Votojmë tani!

Konstatoj se me 43 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim nuk është plotësuar kushti për votim. E përsëris edhe një herë, por në qoftë se nuk plotësohen numrat, atëherë konstatoj që nuk kalon. E përsëris edhe një herë që mos të thoni që patëm problem me kartela.

Edhe një herë, votojmë tani!

Unë mendoj që ky është qëndrim, nuk kalon.

Shpresoj që do të gjendet një zgjidhje. Unë nuk mund të konstatoj nëse duhet përsëritur votimi më, për faktin se përgjigjja është konkrete. Shpresoj që vërtet kemi ardhur në pikën që ndoshta grupet parlamentare duhet të deklarohen, por sidoqoftë nuk ka kaluar dhe presim që në seancat e ardhshme të vendosim për procedurat e mëtejshme.

Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*